

NJOFTIM PËR SHTYP

Në kuadër të promovimit të mëtejshëm të kulturës së konkurrencës, në datën 14.12.2023, në ambientet e Fakultetit të Drejtësisë, u zhvillua Workshop-i me temë "Promovimi i mëtejshëm i kulturës së konkurrencës me botën akademike" në bashkëpunim me Universitetin e Tiranës, me pjesëmarrjen e Kryetarit të Autoritetit të Konkurrencës, Z. Denar Biba, përfaqësues të AK, profesorë dhe studentë në fushën e drejtësisë dhe ekonomisë

Në këtë takim u bë prezantimi i Ligjit Nr. 9121/2003 nga Kryetari i Autoritetit të Konkurrencës, me qëllim sigurimin e njohurive të nevojshme në fushën e ligjit të konkurrencës. Gjithashtu, u prezantua rasti i përqëndrimit nëpërmjet përfitimit të kontrollit të shoqërisë Albania Telecom Invest AD nga shoqëria 4iG Nylvanosan Mukodo Reszvenytarsasag në tregun e komunikimeve elektronike, si dhe rasti i abuzimit me pozitën dominuese të shoqërisë SGS Automotive Albania SHPK në tregun e shërbimit të kontrollit teknik të detyrueshëm të mjeteve rrugore me motor dhe rimorkiove të tyre në Republikën e Shqipërisë, nga përfaqësues të AK. Gjatë takimit kishte diskutime dhe pyetje të ndryshme nga auditori të cilat morën përgjigje nga Kryetari z. Biba dhe përfaqësuesit e tjerë të Autoritetit të Konkurrencës.

Këto workshop-e dhe takime informative/edukuese do të vijojnë të organizohen nga Autoriteti i Konkurrencës jo vetëm në kuadër të sugjerimeve të Rezolutës së Kuvendit të Shqipërisë, "Për vlerësimin e veprimtarisë së Autoritetit të Konkurrencës për vitin 2022", por edhe si mision që autoriteti i ka vendosur vetes për promovimin e mëtejshëm të kulturës së konkurrencës përmes intensifikimit të marrëdhënieve me botën akademike për çështjet e rregullimit të tregut.